



## TERMAT DHE KUSHTET E PËRDORIMIT PËR TERMINALIN POS FIZIK

### **KUSHTE TE PERGJITHSHME:**

Palët e mësipërme bien dakort që me anë të kësaj kontrate të rregullojnë marrëdhëniet ndërmjet Tregtarit dhe Rubicon Sh.a, në lidhje me pagesat elektronike me akses në distance, nepermjet POS. Tregtari bie dakort të pranojë si mjet pagese pagesat elektronike të lëshuara dhe të mbështetura nga shërbimet e Rubicon Sha. Kjo kontrate përcakton kushtet sipas të cilave tregtari mund të përdorë POS-e fizike të ofruar nga Rubicon.

### **BAZA LIGJORE:**

Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë neni 659 e vijues, Ligji nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për Bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Vendimi nr. 28, datë 30.03.2005 i Bankës së Shqipërisë, "Për miratimin e rregullores "Për Mbikqyrjen e Transaksioneve Bankare në Rruge Elektronike", Vendimi nr. 11, datë 06.02.2008 i Bankës së Shqipërisë, për miratimin e rregullores "Për instrumentet e pagesave elektronike".

### **PERKUFIZIME:**

Në kuptim të zbatimit të kësaj kontrate, me termat e mëposhtme do të kuptojmë: **Pagesë elektronike:** Eshtë transaksioni i pagesës, i realizuar nëpërmjet një karte që përmban një shirit magnetik, një mikroqark ose një kod identifikues dhe që përdoret në një terminal pagesash elektronike apo nëpërmjet një aplikacioni bankar duke përdorur mjete elektronike të komunikimit.

**Shoqëri:** Çdo entitet i formuar për të administruar dhe promovuar Kartat, përfshirë, pa limitim MasterCard International dhe VISA International.

**Autorizim:** Aprovim nga institucion financiar për të vërtetuar një transaksion për një tregtar ose një institucion financiar tjetër anëtare.

Një autorizim tregon vetëm vlefshmërinë e limitit të kreditit të Kartëmbajtësit në kohën që Autorizimi kërkohet.

**Tregtar:** Eshtë personi fizik ose juridik, që ushtron aktivitet tregtar në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë, i cili në bazë të kontratës së lidhur me Rubicon, pranon pagesat me IPE-në nëpërmjet përdorimit të një pajisjeje POS/EFTPOS/vitua I POS.

**Terminal POS:** Eshtë pajisja që bën të mundur përdorimin e kartave të pagesave të lëshuara nga një Institucion Financiar, anëtar i një Organizate Ndërkombëtare Pagesash. **Terminal virtual POS (virtual POS):** Eshtë pajisja e ngjashme në shërbime me terminalin POS, e cila mundëson kryerjen e transaksioneve nepermjet internetit ose telefonave, me ane të kartave bankare që punojnë në regjim online.

**Regjim online:** Eshtë regjimi në të cilin transaksionet që kryhen me IPE-në nëpërmjet mjeteve elektroteknike të komunikimit midis sistemit ku kryhet ky transaksion dhe sistemit autorizues të emetuesit të kartës ose operatorit të shërbimit të saj, miratohen menjëherë nga ky i fundit duke bllokuar fondet në llogarinë e mbajtësit të IPE-s.

**Instrument i pagesave elektronike (IPE):** Eshtë instrumenti i pagesave që i mundëson mbajtësit/klientit të kryejë pagesa elektronike. Këtu përfshihen si instrumentet e pagesave me akses në distancë, ashtu edhe instrumentet e parasë elektronike.



**Emetues:** Eshtë Rubicon, që në bazë të kontratës i lëshon mbajtësit për përdorim, IPE-n.

**Mbajtës/Klienti:** Eshtë personi, i cili në bazë të kontratës përkatëse me emetuesin mban IPE-n, referuar ndryshe si klienti.

**Kartë bankare:** Një kartë e vlefshme plastike, e përdorshme si instrument pagesash elektronike, e cila i mundëson kartëmbajtësit të kryejë pagesa nëpërmjet saj, që është lëshuar nga Banka, si anëtare e një Organizate Ndërkombëtare Pagesash.

**Kartëmbajtës:** Personi emri i të cilit është stampuar në Kartë, i cili në bazë të kontratës përkatëse me Bankën emetuese mban IPE-n.

**PIN-i:** Numri personal i identifikimit, që përdoret për të identifikuar kartëmbajtësin. Në transaksionet elektronike ai konsiderohet si një ekuivalent i një nënshkrimi të autorizuar. **Llogaria e tregtarit:** Llogaria e çelur nga tregtari pranë Rubicon, në të cilën do të kryhen të gjitha likuidimet e transaksioneve të kryera nëpërmjet kartës nga kartëmbajtësit, si dhe e detyrimeve të lindura nga këto përdorime.

**Periudha e bllokimit:** Periudha gjatë së cilës do të bllokohet shuma e veprimeve në rastet kur nuk paguhet një komision për veprimet që kryhen tregtari duke përdorur terminal-in Virtual POS.

**Faturë elektronike "e-bill":** Eshtë një dokument që tregon detajet e një shërbimi të kryer nëpërmjet pageses elektronike, që mund të përmbajë të gjitha ose disa nga të dhënat e mëposhtme, por jo duke u kufizuar në: përshkrim të shërbimit të kryer apo mallit të blerë, shumën totale të detyrimit, emrin e biznesit dhe numrin e tregtarit.

**Kufiri maksimal i lejuar:** Shuma e përcaktuar nga Rubicon për çdo transaksion të kryer nëpërmjet kartës, për të cilin nuk kërkohet miratim paraprak nga Rubicon. Nëse shuma e veprimit e tejkalon kufirin maksimal të lejuar, autorizimi paraprak është i domosdoshëm. **Komision:** Shuma që tregtari duhet t'i paguajë Rubicon, për çdo transaksion të kryer nëpërmjet kartës në POS-e fizike ose Virtual POS.

**Autorizim Telefonik:** Eshtë një aprovim verbal i marrë nëpërmjet komunikimit telefonik midis Tregtarit dhe Rubicon ose Agjentëve të saj.

**Chargeback (Kthim shume):** Procesi i anulimit të transaksionit të kryer dhe tërheqjes së fondeve të kredituara (shumën e blerjes) prej llogarisë likuiduese të tregtarit. **Komision**

**"Charge back":** Komision që mbahet sa herë që një transaksion bëhet charge back tek tregtari.

**Kreditim:** Rimbursim ose rregullim i çmimit të një transaksioni të kryer më parë nga tregtari.

**Shërbim:** Shërbimet që Rubicon i ofron tregtarit për të mundësuar tek kartëmbajtësit pagesën e mallrave/shërbimeve të ofruara prej tij.

**PCI DSS :** PCI DSS e njohur si Payment Card Industry Data Security Standard është një bashkësi udhëzimesh, masash dhe kontrollesh të cilat janë zhvilluar për të ndihmuar tregtarët për të implementuar masa parandalimi për të siguruar përdorimin e kartave dhe ruajtjen e informacionit.

**Raport i dorezimit të mallit (Delivery report):** Eshtë dokumenti që verteton marrjen në dorezim të mallit i nënshkruar nga klienti, dhe që përmban gjithmone nënshkrimin e zotëruesit të kartës bankare.

**3D Secure:** Sistem për identifikimin e kartëmbajtësit në kohe reale duke përdorur një fjalekalim dhe për të ofruar një nivel sigurie sa më të lartë për pagesat me kartë në internet nëpërmjet njerës prej skemave më poshte: Verified by VISA (VbV) MasterCard Secure Code

## PRANIMI I PAGESAVE ELEKTRONIKE.

### 1. TE DREJTAT DHE DETYRIMET E TREGTARIT

Nëpërmjet kësaj kontrate, tregtari ka të drejtë të pranojë të gjitha shërbimet e ofruara nga Rubicon për pagesat elektronike.

Kërkesat e mëposhtme aplikohen për të gjitha transaksionet që kryhen me anë të kartave:

a) Tregtari duhet të çele (nese nuk ka) një llogari pranë Rubicon SHA, në mënyrë që përfitojë nga ky shërbim;



- b) Tregtari nuk mund të vendosë shumë minimale dhe maksimale si kusht për pranimin e një pagese elektronike;
  - c) Tregtari nuk mund të imponojë një shtesë në çmim ose taksë si kusht për pranimin e një pagese elektronike;
  - ë) Tregtari nuk mund të vendosë ndonjë kusht të veçantë për pranimin e një pagese elektronike;
  - d) Tregtari nuk mund të vendosë procedura që dekurajojnë, favorizojnë ose diskriminojnë përdorimin e pagesës elektronike;
  - e) Çdo taksë që mund të aplikohet duhet të përfshihet në shumën totale të transaksionit dhe jo të merret në cash;
  - gj) Tregtari nuk mund të kryejë një transaksion ose shitje që është bërë më parë charge back;
  - f) Tregtari mund të ruajë në sistemin e tij elektronik të dhëna të klientit që kanë të bëjnë me numrat, llogaritë bankare, PIN-et, apo çdo të dhënë tjetër të klientit, vetëm nëse aplikon standartet e **PCI DSS** e njohur si Payment Card Industry Data Security Standard.
1. Për të mundësuar kryerjen e pagesave elektronike, tregtari ka të drejtën e përdorimit të POS-ve fizike, dhe softwarit përkatës të siguruar nga Rubicon.
  2. Tregtari është përgjegjës për identifikimin e të dhënave të kartëmbajtësit dhe vlefshmërisë së pageses elektronike. Vetëm pasi verifikohen këto, tregtari duhet të pranojë në këmbim të mallrave/ shërbimeve të ofruara prej tij të gjitha pagesat elektronike të përcaktuara nga Rubicon, konform rregullave të kësaj kontrate.
3. Tregtari duhet të mbajë raportin e dorezimit të mallit të nënshkruar nga klienti, të çdo transaksioni të kryer nepermjet pagesave elektronike dhe duhet të ruajë kopjen e faturës së transaksionit të paktën 3 vjet pas kryerjes së tij.
4. Çdo transaksion elektronik që do të kryhet mund të përmbajë të gjitha ose disa nga të dhënat e mëposhtme, por jo duke u kufizuar në të:
    - a) numrin e kartës dhe datën e skadimit,
    - b) firmën apo nënshkrimin elektronik të Kartëmbajtësit,
    - c) një përshkrim i shkurtër i shërbimeve të kryera,
    - d) shumën totale të detyrimit,
    - e) emrin e biznesit dhe numrin e tregtarit.
  5. Tregtari merr përsipër të gjitha risqet nëse kryhen transaksione ku pagesa elektronike nuk përmbush parametrat e përcaktuara në këtë kontratë.
  6. Tregtari nuk mund të pranojë transaksione që kalojnë shumën maksimale të limitit të përcaktuar të kartës.
  7. Përpara dhënies së mallit/shërbimit, tregtari duhet të marrë paraprakisht një autorizim elektronik, në rast se shuma e transaksionit e tejkalon kufirin maksimal të lejuar. Në të kundërt, Rubicon nuk mban asnjë përgjegjësi dhe tregtari është përgjegjës për humbjet e shkaktuara (nëse ka).
  8. Një Autorizim tregon vetëm disponueshmërinë e kreditit në llogarinë e kartëmbajtësit në kohën kur ky Autorizim kërkohet. Ai nuk garanton që transaksioni është kryer nga Kartëmbajtësi i duhur, as nuk është një premtim ose garanci që ju nuk do bëheni subjekt i një Chargeback. Autorizimet nuk bëjnë të vlefshme veprimet e kryera me karta të falsifikuara, të vjedhura, të cilave iu ka kaluar afati dhe/apo nëse kryhen veprime jo të ligjshme. Tregtari pranon se në raste të tilla është plotësisht përgjegjës për çdo pagesë të kthyer, tërheqje mbrapsh të fondeve nga llogaria e tij edhe në rastet kur titullari i kartës nuk e ka pranuar transaksionin, sepse mallrat nuk janë marrë, janë me defekt, ose shërbimi nuk është kryer ose është i papërshtatshëm.
  9. Tregtari mund të kryejë transaksione për shumën nën kufirin maksimal të lejuar (nëse ka një të tillë) pa marrë autorizim elektronik, por në këto raste duhet të tregohet shumë i kujdesshëm.



10. Autorizimi paraprak përcaktohet si një kërkesë për të bllokuar një shumë të caktuar në llogarinë e mbajtesit të kartës, për tu siguruar që ka fonde të mjaftueshme për kryerjen e një veprimi. Autorizimi elektronik online është i detyrueshëm.
11. Tregtari duhet të refuzojë pagesën elektronike nëse ka arsye për të besuar se pagesa nuk është paraqitur nga mbajtesi i IPE-s dhe të njoftojë menjëherë Rubicon.
12. Tregtari pranon pa asnjë kundërshtim apo kontestim aktual dhe të ardhshëm, çdo dokumentacion të paraqitur nga Rubicon, në lidhje me të gjitha transaksionet e kryera.
13. Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin midis tregtarit dhe mbajtesit të IPE-s në lidhje me procedurën e pagesës nëpërmjet kartës, duhet të zgjidhen midis tyre dhe Rubicon nuk mban asnjë përgjegjësi.
14. Tregtari duhet të sigurojë të gjithë suportin teknik për mirembajtjen dhe funksionimin normal të vazhdueshëm, me qëllim mospengimin e funksionimit të POS-it.
15. Tregtari nuk do të kundërshtojë Rubicon asnjë kërkesë apo padi, në rruge administrative apo gjyqësore, lidhur me ndonjë dem moral apo financiar, që mund të shkaktohet nga mosfunksionimi i POS-it, për çfarëdo lloj arsyeje.
16. Tregtari, nëse aplikon standartet e **PCI DSS** e njohur si Payment Card Industry Data Security Standard, është i detyruar që çdo të dhënë të mbajtesit të IPE-s (të mësuar në mënyrë direkte ose indirekte) ta ruajë dhe të mos ua shpërndajë personave të tretë, përveçse personave të autorizuar. Në të kundërt është përgjegjës për çdo lloj dëmi që do t'i shkaktohet Bankës ose mbajtesit të IPE-s.
17. Tregtari duhet të kujdeset për procedurat e sigurisë dhe të mos bëjë publike të dhenat personale dhe numrin e kartës së mbajtesit, si dhe të mos lejojë përdorim të gabuar/pasakte, falsifikim/kopjim të IPE-s.
18. Porosia e dhënë nga klienti/mbajtesi i IPE-s, për autorizimin e transaksionit mund të kthehet vetëm para autorizimit të tij. Pas autorizimit të transaksionit nga mbajtesi, porosia është e pakthyeshme, përveç rasteve kur termat për përdorimin e IPE-s, ose/dhe rregullat e cilesisë dhe garancisë së tregtarit, parashikojnë ndryshe.
19. Tregtari mban përgjegjësi si kundërshtues të mbajtesit të IPE-s ashtu dhe kundërshtues të Rubicon për çdo veprim të gabuar të tij apo nderhyrje të paautorizuara, ku si rrjedhojë mbajtesit të IPE-s ose Rubicon janë dëmtuar nga ky veprim arbitrar i tij.
20. Informacioni i transmetuar në momentin e pagesës nga ana e klientit/mbajtesit të IPE-s nuk duhet të cenohet në asnjë formë/menyrë, mbrojtjen e të dhenave personale. Informacioni personal i klientit/mbajtesit të IPE-s, në lidhje me veprimet e tij, mund të bëhen publike vetëm institucioneve shtetërore, vetëm në rastet e lejuara dhe të përcaktuara shprehimisht nga legjislativi në fuqi.
21. Tregtari duhet të ketë të paktën një llogari të çelur pranë Rubicon, me qëllim që të mundësohet kryerja e pagesave nëpërmjet pagesave elektronike. Në këtë llogari, si rregull duhet të ketë fonde të mjaftueshme për të mbuluar të gjitha veprimet, përfshirë tarifën, komisionet, interesat. Me këtë kontratë tregtari autorizon Rubicon për të tërhequr nga llogaria e tij, të gjitha pagesat që duhen kryer. Tregtarët sipas vlerësimit të pavarur nga Rubicon, duhet të bllokojnë një shumë të përcaktuar nga Rubicon, shumë kjo që i bëhet e ditur tregtarit në momentin e lidhjes së kontratës me Rubicon me anë të shtojcës nr.2 bashkëngjitur kësaj kontrate.
22. Tregtari është përgjegjës dhe duhet të kontrollojë llogarinë e tij dhe të njoftojë menjëherë Rubicon me shkrim në rastet mospërputhje.
23. Tregtari duhet të dorëzojë në Rubicon çdo informacion/dokumentacion fizik apo elektronik të shitjeve të kryera nëpërmjet pagesave elektronike, në të gjitha rastet kur Rubicon e kërkon këtë. Nëse nuk paraqitet një informacion/dokumentacion fizik apo elektronik shitjeje i vlefshëm, tregtari mund të bëhet subjekt Chargeback-u.
24. Tregtari deklaron dhe mban përgjegjësi ligjore se i gjithë informacioni i deklaruar apo i dorëzuar prej tij në Rubicon, është i vërtetë dhe i plotë.
25. Tregtari është i detyruar t'i kompensojë Rubicon shumën e transaksionit dhe të komisionit, në rast se transaksioni është i pavlefshëm. Rubicon ka të drejtë të debitojë llogarinë e tregtarit për këtë.
26. Tregtari është i detyruar që të njoftojë menjëherë me shkrim Rubicon për çdo lloj ndryshimi në informacionin e dhënë prej tij në momentin e lidhjes së kësaj kontrate.



27. Në rastet kur mbyll biznesin e tij, tregtari menjëherë duhet të njoftojë Rubicon dhe duhet t'i dorëzojë asaj të gjitha faturat në ruajtje, dokumentet si dhe Manualin e Operimit të POS-it.
28. Tregtari i pranon të gjitha rregullat dhe normat e kësaj kontrate, si dhe të Manualit të Operimit të POS-it, të cilat mund të ndryshojnë dhe/ose shtohen në marreveshje midis paleve. Në rast se tregtari nuk bie dakort me ndryshimet, dhe/ose shtesat, ai mund të zgjidhë kontratën që ka me Rubicon, duke lajmëruar me shkrim në mënyrë të menjehershme për këtë.
29. Tregtari duhet të ndjekë plotësisht të gjitha udhëzimet e Rubicon. Ai është përgjegjës kundrejt Rubicon në rast të mosrespektimit të rregullave të kësaj kontrate dhe të Manualit të Operimit të POS-it.
30. Nëse kontrata dhe Aplikimi juaj si Tregtar aprovohet nga Rubicon, ju do të pajiseni me një Manual Operimi të POS-it, të cilat përmbajnë procedurat e operimit, instruksione dhe udhëzime të tjera për transaksionet me pagesa elektronike.
31. Tregtari merr përsipër të mbajë sekret gjithë informacionin lidhur me këtë kontratë dhe se nuk do të zbulojë informacione të tilla asnjë pale të tretë edhe pas ndërprerjes së kësaj kontrate pa leje paraprake nga Rubicon.
32. Tregtari deklaron se çdo informacion i përfshirë në aplikim ose në dokumenta të tjera të dorëzuara në Rubicon është i vërtetë, i plotë dhe dëshmon me të vërtetë biznesin, kushtet financiare, partnerët kryesorë, pronarët dhe përfaqësuesit zyrtarë të Tregtarit.
33. Tregtari pranon që një kërkesat e PCI DSS, i përmbush këto kërkesa dhe gjate gjithë kohezgjatjes së kontrates do të veproje në përputhje me këto standarte.
34. Tregtari është i detyruar të publikojë në website të tij Termat dhe Kushtet e Përgjithshme të punës me klientet, të cilat duhet të jenë në përputhje me standartet e pagesave online me karte, të cilat duhet të përshkruajnë në mënyrë të qartë dhe specifike politikën e kthimit të një urdheri në emrin e klientit për mallrat/shërbimet, përgjegjësitë e secilës pale në rast të mosrespektimit të kushteve për pagesën e urdheruar, gjithashtu dhe vlerën e detyrimit në rast dështimit të përmbushjes së detyrimeve të çdo pale.
35. Tregtari është i detyruar që gjate ushtrimit të aktivitetit të tij për shitjen e mallrave/shërbimeve nëpërmjet POS-it fizik të mos lejojë kryerjen e shitjeve fiktive apo aktivitet që konsiderohet pastrim parash, vjedhje/mashtime ose edhe tentativa. Në rast të identifikimit të ushtrimit të ndonjë nga aktivitetet e parashikuara në këtë nen të gjitha përgjegjësitë dhe risqet do të mbahen personalisht dhe plotësisht nga tregtari.
36. Dështimi në përmbushjen e ndonjë prej rregullave të mësipërme mund të rezultojë në zgjidhje të kontrates dhe shpërbim të demit.

## **2. TRANSAKSIONE TË PALEJUARA**

1. Tregtari nuk lejohet dhe nuk mund të pranojë pagesa elektronike, përveç se për mallra dhe shërbime që ofron sipas fushës/objektit të licensimit të tij nga autoritetet shtetërore.

## **3. CHARGE BACK:**

Tregtari është përgjegjës për të gjitha rastet kur një transaksion bëhet subjekt i një chargeback.

Arsyet që një transaksion të bëhet charge back janë:

1. Një kartembajtës i IPE-s kundërshton vlefshmërinë e një transaksioni;
2. Një kartembajtës i IPE-s kundërshton cilësinë ose marrjen e mallrave ose shërbimeve;
3. Një kopje e informacionit/dokumentacionit fizik apo elektronik të shitjeve të kryera nëpërmjet pagesave elektronike, nuk është paraqitur, kur është kërkuar nga Rubicon, ose kopja e siguruar ka qenë e plotësuar në mënyrë të papërshtatshme ose ka qenë e palexueshme pjesërisht ose e gjithë;
4. Një mall apo shërbim nuk është dorëzuar/ofruar tek mbajtësi i IPE-s, ose/dhe malli është i parregullt/demtuar, ose/dhe raporti i dorëzimit të mallit nuk është nënshkruar nga mbajtësi i IPE-s;
5. Pagesa elektronike nuk është autorizuar nga Institucioni Financiar lëshues në kohën e shitjes, ose janë bërë përpjekje për të shmangur një refuzim të Autorizimit (të tillë si, por jo të limituar, përpjekje për të marrë Autorizim pas marrjes ose një refuzimi ose një referimi në një call center ose ndarjen e një transaksioni të së njëjtës kartë);



6. Të gjitha transaksionet që kryhen në Internet janë me risk dhe janë subjekt I Charge back; Kur një tregtar bëhet subjekt i një chargeback, tregtarit i ngarkohet shuma e transaksionit dhe një tarifë charge back çdo herë që një transaksion ngarkohet mbrapsht tek tregtari. Nëse Institucioni Financiar kthen mbrapsht një Chargeback për llogari të tregtarit dhe Institucioni Financiar lëshues kundërshton kthimin (i cili mund të shfaqet përmes një Charge back pasues, kërkesë për paragjykim ose një kërkesë për gjykim), transaksioni mund të bëhet charged back përsëri, dhe ju do të pësoni një Chargeback Fee shtesë derisa procesi i plotë i charge back të mbyllet.

#### **4. TE DREJTAT DHE DETYRIMET E RUBICON**

1. Rubicon, për të mundësuar kryerjen e pagesave elektronike, i jep tregtarit të drejtën e përdorimit të POS-it, nepermjet kreditimit të tregtarit me vlerën e mallit/sherbimit kundrejt debitimit me vlerën e komisionit.
2. Rubicon ka te drejte te bllokoje POS-in ne rast identifikimi te transaksioneve te vazhdueshme te dyshuara si false.
3. Rubicon ka të drejtë të bllokoje llogarine bankare te Tregtarit, deri ne sqarimin e transaksioneve te dyshuara si false.
4. Rubicon ka te drejte te preke llogarine e Tregtarit (*te lidhur me POS-in*), ne rast mosplotesimit te kerkesave te Rubicon per paraqitjen e dokumentacionit te kerkuar nga ana e Tregtarit, ne rast te transaksioneve te dyshuara si false. Tregtari i njeh te drejten Rubicon, qe shuma e bllokuar ne kete llogari, te perdoret per te rimbursuar (debituar apo kthyer) Rubicon apo persona te trete, te lidhur me kete transaksion.
5. Rubicon nuk eshte pergjegjese per cdo humbje te mundshme te Tregtarit, qe mund te vije si pasoje e veprimit ne kundershtim me kete kontrate dhe Manualin e Operimit te POS-it.
6. Rubicon kur e konsideron te arsyeshme mund të pezulloje POS-in, pa qene e nevojshme te shpjegoje arsyen e këtij veprimi.
7. Rubicon mund të vendosë kufizime për kryerjen e disa transaksioneve, për të cilat transaksionet nuk janë të lejuara ose te kufizuara sipas legjislacionit ne fuqi.
8. Rubicon ka të drejtë të deklarojë si të pavlefshëm transaksionin e kryer, në rast se tregtari shkel këtë kontrate dhe në rast se mbajtes i IPE-s bën ankesë të drejtë lidhur me pasaktësi në transaksionin e kryer. Në rastet e shkeljes së kësaj kontrate Rubicon ka të drejtë të debitojë llogarinë që tregtari ka çelur pranë saj, në mënyrë të njëanshme dhe pa bashkëpunimin e tij.
9. Rubicon ka te drejte te mbaje pezull pagesen apo te percaktoje daten e pageses, deri ne momentin qe verifikon perputhshmerine e pageses sipas pikave 4.3 dhe 4.4 te kesaj kontrate.
10. Më poshtë tregohet një listë me arsye të tjera për të cilat Rubicon debiton llogarinë e tregtarit, por jo duke u kufizuar vetem ne keto. Ne mund t'i shtojmë kësaj liste siç kërkohet: (a) detyrime dhe gjoba të vlerësuar si rezultat i transaksioneve tuaja; (b) gabime të konvertimit të monedhave; (c) komisione dhe Chargeback jo të ngarkuara më parë; dhe (d) depozitime të postuara gabim.
11. Rubicon do të njoftojë me shkrim tregtarin për komisionet e reja përpara se ato të bëhen efektive.
12. Rubicon ka të drejtë të përcaktojë dhe ndryshojë instruksionet në lidhje me POS-in, shërbimet dhe rregullat rreth autorizimit të transaksioneve.
13. Rubicon është e detyruar të mbajë sekret informacionin e marrë nga tregtari dhe te zbatoje aktet ligjore per ruajtjen e te dhenave dhe sekretit bankar, me përjashtim të rasteve kur urdhërohet me vendim gjyqësor apo institucionet shteterore qe i njihet kjo e drejte me ligj.
16. Pagesat bëhen në Lek (nqs nuk kanë të drejtë të bëhen në monedhë tjetër) në llogaritë që kanë pranë Rubicon

#### **5. KOMISIONET LIGJORE**

Tregtari është përgjegjës për dhe do të shpërblejë dhe rimbursojë Rubicon për të gjitha komisionet ligjore, shpenzimet dhe kosto të tjera të paguara nga Rubicon në zbatim të kësaj Kontrate, ose në mbledhjen e çdo shume të detyruar nga Tregtari kundrejt Rubicon që rezultojnë nga çdo shkelje e kësaj Kontrate nga Tregtari.



## **6. EKSKLUZIVITETI**

Gjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së Marrëveshjes së Tregtarit, tregtari do të përdorë të gjitha pajisjet e RUBICON vetëm për të kryer shërbimet e ofruara nga RUBICON lëshuese dhe nga asnjë subjekt tjetër.

## **7. KOHEZGJATJA E KONTRATES**

Kjo marrëveshje fillon në datën e nënshkrimit të saj dhe vazhdon për një afat të pacaktuar kohor.

Rubicon ka të drejtë ta ndërpresë këtë marrëveshje vetë, pa paralajmërim dhe në çdo kohë, në rast se tregtari nuk paguan detyrimet që lindin sipas kesaj kontrate brenda afatit të percaktuar dhe në rast konstatimit të shkeljeve ligjore pjesë e kesaj kontrate. Tregtari ka të drejtën e zgjidhjes së kësaj kontrate me Rubicon, me paralajmërim me shkrim prej 30 (tridhjetë) ditësh.

Në rast të zgjidhjes së mundshme të kontratës për çfarëdo lloj shkak, tregtari detyrohet të kthejë Rubicon të gjithë dokumentacionin e marre prej Rubicon.

## **8. ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**

Për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë, palët bien dakord se zgjidhja do të bëhet me mirëkuptim midis tyre. Në të kundërt, palët do t'i drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

## **9. TE NDRYSHME**

Asnjë palë nuk do të mbajë përgjegjësi për vonesën apo dështimin e përmbushjes së ndonjë detyrimi pjesë e kësaj kontrate, në rast se kjo shkaktohet nga rrethana që janë jashtë përgjegjësisë së kontrollit të palëve.

Kontrata hartohet në dy kopje, ku secila palë merr nga një kopje.

Kontrata nënshkruhet nga palët me vullnet të plotë, të lirë dhe të pavarur.

## **10. NUMRI I SHËRBIMIT**

Tregtari për çdo problem që do të ketë për problem të raportuar nga klienti/mbajtësi I IPE-s duhet të kontaktojë në numrin special të telefonit: +355 69 666 0031 të ofruar nga Rubicon.